



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Njësia org. Org.Jedinita Org.Unit	ARPL
Nr. i Faqeve Br. Stranica No. Pages	- 09 -
Nr. i Prot. Broj Prot. Prot. No.	4766-2/2r
Data: Datum: Date:	25.09.25
PRISHTINË / A	
No. 1	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalnoq Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	19.09.2025
REFERENC-Ë:	4766/25 ZSP - 2025
PËR/ZA/TO:	Komuna e Deçanit, Rr Jashar Salihu, Nr 3, 51000, Deçan
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Z. Izedin BYTYQI, U.D. - Sekretar i Përgjithshëm i MMPHI-së; Z. Fatos QERIMI, Drejtori ARPL-së; Z. Fidan BILALLI U.D. Udhëheqës i Divisionit të Akteve dhe Financave
NGA/OD/FROM:	Muhamed MELEQI, Zyrtar i Lartë për Leje Ujore Shfrytëzim të Ujit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim

Të nderuar,

Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore pranë Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, bazuar në kërkesën me Nr. Protok. 4766/25, datë 18.06.2025, lidhur me projektin "Rregullimi i shtratit të lumit Baballoq" në fsh. Baballoq, K. Deçan, me gjatësi L= 1,900 m. Pas shqyrtimit të lëndës, ka vendosur si në vendimin e bashkangjitur të kësaj shkrese përcjellëse.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planing and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr. PU

Datë: 19.09.2025

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjensive të Pavarura (Shtojcës 1 pika 10 të Rregullores Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenin 71 të Ligjit Nr. 04/L -147 Për Ujërat e Kosovës, nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, U.A. MMPH Nr. 03/2018 për Procedurat për Leje Ujore, nxjerrë këtë:

V E N D I M

APROVOHET kërkesa për **Pëlqim Ujor për kalim në kompetencë të Komunes Deçan**, me nr. Protok. 4766/25, për projektin **“Rregullimi i shtratit të lumit Baballoq” Z.K. Baballoq, K. Deçan**, me gjatësi L=1,900m:

1. Pëlqimi Ujor lëshohet në bazë të dokumentacionit tekniko – investiv, bazuar në pikat gjeodezike, për rregullimin e shtratit të lumit Baballoq në gjatësin, L= 1.9 km. Andaj si i tillë ruhet nga pala, nën kushtet si në vijim:
2. Rregullimi i shtratit të lumit Baballoq, të relizohet sipas projektit, në gjatësin L = 1.9 km, të hartuar nga kompania, me të cilën kompani K. Deçan do të bie në ujdj për rregullim të lumit;
3. Pala duhet të ketë parasysh se, nuk lejohet që shtrati lumit (bentosi), të betonohet apo kombinim të betonit me gure, sepse duhet të jete i lire në tërë gjatësinë;
4. “Rregullimi i shtratit të lumit Baballoq“, duhet harmonizuar me projektet egzistuese si dhe të ruhet rregjimi ujor, duke mos i dëmtuar të njejtat, çdo pengesë apo demtim të projekteve egzistuese, pala duhet të eliminojë dhe të njejtat të kompenzojë;

5. Dy urat e parapara duhet te punohen sipas legjislacionit ne fuqi për konstrukcione do te mbikqyren nga ekspert të lëmisë përkatëse ing i licencuar, Kategoria A, Drejtimi Konstruktiv;
6. Para fillimit të punimeve të sillet situacioni i hartuar, nënshkruar dhe vulosur nga person fizik apo juridik i lëmise perkatese gjeodet, me të gjitha profilet e parapara për rregullim, çdo 50m, ndersa në pjesët karakteristike çdo 25m;
7. Materiali i deponuar për shkak të grumbullimit të mundëshëm, për të cilin parashihet nevoja për largim, ku konsiderohet se pengon lëvizjen e natyrshme të ujërrjedhës, që parashihet si rrezik potencial të krijimit të vërshimeve. Organi Komunal i cili është i obliguar të bëjë mbikqyrjen e zhvillimi të punimeve të cilat duhet të jenë në përpuethshmëri të plotë me dispozitat ligjore për ujëra, njëkohsisht duhet ti paraqes profilet, ku është nxjerrë materiali, të kalkuloj kubaturën si dhe të bëjë pagesën e materialit sipas dispozitave të parapara në fuqi;
8. Elaborati i dinamikës së nxjerres së materialit, dhe rehabilitimi pas këtijë aktiviteti të prezantohet në formë ditari për secilin segment, në MMPHI, konformë “U.A. MMPH 03/2018, për procedurat për leje ujore”;
9. Pëlqimi ujqor ka afat një vjeçar, dhe pas kalimit të kësajë periudhe kohore, pala duhet të bëjë kërkesë të veçant, po që se paraqitet nevoja, sepse aktualisht me legjislacionin në fuqi nuk parashihet ndryshe;
10. Pëlqimi ujqor për nxjerrjen e materialit ndërpritet edhe para afatit të përcaktuar nga paragrafi si më sipër, nëse gjatë kontrollit nga inspektorati i ujërave komunal dhe qendrorë, vërtetohet se kryesi i punëve nuk iu është përmbajtur kushteve të përcaktuara me pëlqim ujqor;
11. Raportet duhet të jenë të nënshkruara dhe me datë, në ditën kur janë kontrolluar nga organi mbikqyrës i Komunës së Deçanit;
12. Vendi për deponimin e materialit, duhet të jet i caktuar, dhe me prezantim të ngastrës së paraparë dhe për çdo ndryshim pala duhet ta informoj Organin i cili e ka lëshuar këtë Pëlqim Ujqor;
13. Pala detyrohet që të bëjë inçizimin gjeodezik të shtratit të segmentit të lumit të rregulluar, pas kryerjes së punimeve dhe të njëjtin ta prezantojë pranë Organit që e ka lëshuar Pëlqimin ujqor;
14. Pastrimi i dërrunjëve nuk është në Kompetencë të MMPHI-së dhe duhet të kërkohet nga organi përgjegjës, sepse ARPL-ja nuk ka kompetenca përveq se organi kompetent;
15. Punëkryesi i detyrohet MMPHI-së, që materialin ranor dhe gurorë të larguar ta prezantojë realisht si dhe vendëndodhjen, pranë organit përgjegjës që e ka lëshuar këtë Pëlqim ujqor, për shkak të vlerësim financiar, sipas U.A për strukturën e pagesave në fuqi;



ARSYETIM

Pala, Komuna e Deçanit, ka aplikuar për Pëlqim Ujor, lidhur me “Rregullimin e shtratit të lumit Baballoq, me $L=1.9\text{ km}$ ($L=1,900.0\text{ m}$ K. Deçan; Kërkesës i ka bashkangjitur: Pagesen e tarifës, e rastin e aplikimit, sipas shtojces 6 të “Udh. Adm. MMPH. 03./2018 Për Procedurat Për leje ujore, në vlerë 2000 € (Dy mijë euro); Paramasa dhe parrallogaria për rreg. E shtratit të lumit Baballoq; Situacionin, me përpjese të lexueshme 1:2000, (jo i punuar nga person i lemise pekatese), ashtu siq parashihet me Udh. adm 03/2018; ”Projekti kryesor i Rregullimit të shtratit të lumit në fsh Baballoq, $L = 1,900.00\text{m}$ ’ Masat e mbrojtjes dhe Përmirsimit; Analiza e rrjedhave dhe e përmbytjeve; Reshjet maksimale; Situacioni dhe profili gjatësor për Lumin Erenik (matje gjeodezike çdo 25m), hartuar vulosur dhe nënshkruar nga “Geo Point”; Raporti përfundimtar dhe rekomandimet (Profili gjatësor; Prerjet karakteristike tërthore);

Vërejtje:

- Ky projekt do të realizohet, me qëllim të mbrojtjes nga dëmet që po shakrohen nga përbytjet e tokave bujqësore dhe shtëpit e banimit;
- Pala vërejtjet e bëra si me sipër, duhet ti eliminoj në afatin sa me të shkurtër kohor, dhe te njejtat ti prezantoj pranë organit që e ka lëshuar këtë pëlqim ujor.

Andaj bazuar në kërkesën e K. Deçan, për “Rregullimi e shtratit të Lumit Baballoq” dokumentacionit – investivo teknik të hartuar, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore të Prishtinës, në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, nga dita e pranimi të njëjtit.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr.: 4766/25 – ZSP - 2025 Datë: 19.09.2025

Prishtinë

T’i dërgohet:

- Komunës Deçan;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- ARPL-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Arkivit të Ministrisë.

U.D. - Sekretar i Përgjithshëm i MMPHI-së

Izedin BYTYQI